

## Vllaznia i dhuron kryesimin Kukësit

nga Albaniassocer

E shtunë, 24 Janar 2015 18:50

---



Vllaznia-Kukësi 1-2 Pejçic 6,Lushtaku 59,Kalaja 66

Ekipi shkodran me ane te Sykajt i dhuroi nje gol te shpejte Pejçicit te Kukësit.

Ndeshja ne Shkoder hapet me golin e shpejte te Kukësit por mund te thuhet se ishte nje dhurate e Sykajt per Pejçicin. Nga nje goditje kendit mbrojtësi shkodran gabon goditjen me koke dhe i dhuron topin Pejçicit qe nuk fale Selimajn nga fare afer. Vllaznia mundohet te reagojne por pa arritur te rrezikonte porten e Halilajt. Ne pjesen e dyte Kukësit dyfishon rezultatin me nje goditje te lire spektakolare te Lushtakut. Ne dizavantazh te dy golave u duk sikur shkodranet u zgjuan dhe fituan nje penalti shume te dyshimte per nje faull me dore te Dushkut. Shtubina e merr per siper realizimin por gjuajtja e tij pritët nga Halilaj. Pas keti episodit eshte i riu Kalaja qe me nje levizje te bukur shmang mbrojtjen kuksiane dhe shenon nje gol shume te bukur. Si per te konfirmuar mbremjen negative te tije Shtubina shperdoron nje tjetër rast shenimit prane portes kuksiane. Dy raste te thjeshta paten edhe Kuksianet me Lushtakun dhe Pejçicin por nuk arrihen dot te thellonin rezultatin.